

03/09/2019

## **Mitropliti i Apollonisë dhe Fierit +Imzot Nikolla - Mesazh ngushëllimi**



Drejtuar: Atë Artur Liolinit, gjithë klerit dhe popullit besimtarë të Kryedioqezës Shqiptare të Amerikës!

I nderuar Atë Liolini,  
Të nderuar etër dhe vëllezër më Krishtin!

Ju shprehim ngushëllimet tona për ndërrimin e jetës së Imzot Nikonit, Kryepiskop i Kryedioqezës Shqiptare të Amerikës dhe New England!

Ne kujtojmë me mirënjohje mbështetjen dhe ndihmësen e Imzot Nikonit, Tuajën dhe gjithë komunitetit orthodhoks shqiptarë të Amerikës, në Shërbesën e Kishës Orthodhokse këtu në Shqipëri, Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Imzot Anastasit si edhe në atë të Mitropolisë sonë të re, të Apollonisë dhe Fierit!

Besojmë dhe lutemi, që Zoti ta preh shpirtin e Tij me të drejtët dhe ta denjësojë të

meshojë në Altarin Qiellor!  
I përjetshëm qoftë kujtimi i Tij!  
Me dashuri vëllazërore më Krishtin,  
Mitropliti i Apollonisë dhe Fierit  
+Imzot Nikolla

- [facebook.com/MitropoliaFier](https://www.facebook.com/MitropoliaFier)